



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCËVE VENDORE

Nr. 9739 prot.

Tiranë, më 18.6 2025

Lënda: Dërgohen mendimet mbi Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028

BASHKISË Divjake ✓

KËSHILLIT TË QARKUT _____

Në zbatim të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar dhe të udhëzimit vjetor të Ministrit të Financave nr.8 datë 28.02.2025, "Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028", bashkëlidhur ju dërgojmë komentet dhe rekomandimet e Ministrisë së Financave mbi projekt-dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije që procesi dhe procedura e vazhdimit të fazës së dytë për miratimin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor do të zbatohet në përputhje të plotë me kërkesat ligjore të ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Besmir Beja

Besmir





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E FINANCEVE VENDORE

ANALIZA E PBA 2026-2028

BASHKIA DIVJAKË ENTITETI QEVERISËS 147

1. Vështrim i Përgjithëm

Programi Buxhetor Afatmesëm paraqet në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave e burimeve buxhetore dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ai përfshin lidhjen e qëllimeve të politikës së programit dhe objektiveve të bashkisë me qëllimet strategjike të përcaktuara në strategjitë kombëtare dhe lokale. Procesi i PBA-së, synon disiplinimin e financave vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Po ashtu ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve, duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësive vendore, përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioritetëve vjetorë të shpenzimeve.

Bashkia Divjakë ka realizuar Programin Buxhetor Afatmesëm 2026-2028 në afatet e përcaktuara në ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" duke e plotësuar elektronikisht dokumentin PBA sipas standardeve të përcaktuara nga Ministria e Financave në Udhëzimin nr.8 datë 28.2.2025 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2026-2028" në SMBV - Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor, në portalin Financat e Vetëqeverisjes Vendore www.fvv.al në faqen e Ministrisë e Financave.

2. Lista e Programeve të NJVQV-së

Buxheti Afatmesëm 2026-2028 i bashkisë Divjakë, sipas klasifikimit funksional Niveli I dhe III i COFOG, si dhe raportit PBA5 ka programet si më poshtë vijon:

FUNKSIONI 01	SHËRBIMET E PËRGJITHSHME PUBLIKE
1. 01110	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi
FUNKSIONI 03	RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE
2. 03140	Shërbimet e Policisë Vendore
3. 03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
FUNKSIONI 04	ÇËSHTJET EKONOMIKE
4. 04130	Mbeshtetje e zhvillimit ekonomik
5. 04240	Menaxhimi i ujitjes dhe kullimit
6. 04260	Menaxhimi i pyjeve dhe kullotave
7. 04520	Rrjeti rrugor rural
FUNKSIONI 05	MBROJTJA E MJEDISIT
8. 05100	Menaxhimi i mbetjeve
FUNKSIONI 06	STREHIMI DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT

9. 06260 Shërbimet publike vendore
 10. 06370 Furnizimi me ujë dhe Kanalizimet
FUNKSIONI 08 ARGËTIMI, KULTURA DHE ÇËSHTJET FETAKE
 11. 08130 Sport dhe argëtim
 12. 08220 Trashëgimia kulturore, monumentet, muzetë dhe bibliotekat
FUNKSIONI 09 ARSIMI
 13. 09120 Arsimit bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor
 14. 09230 Arsimit mesëm i përgjithshëm
FUNKSIONI 10 MBROJTJA SOCIALE
 15. 10430 Kujdesi social për familjet dhe fëmijët

Lista e programeve të përdorura nga bashkia Divjakë është në përputhje me shtojcën 1 të udhëzimit nr.7 datë 25.2.2022. Në raportin PBA5 Bashkia ka listuar në fakt 16 programe ku përfshihet edhe programi 10661 Strehimi Social, por që nuk ka fonde të buxhetuara në asnjë nga vitet, pra janë përdorur në total 15 programe si më sipër renditur, pa përfshirë fondin rezervë dhe kontigjencën.

3. Komente të përgjithshme

- Bashkia e ka përgatitur dhe dorëzuar relacionin dhe tabelat output të SMBV-së për programin buxhetor afatmesëm 2026-2028 brenda afatit të përcaktuar në ligjin nr.68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Programi buxhetor afatmesëm për periudhën 2026-2028, është përgatitur nga bashkia Divjakë në Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV);
- Vlerësojmë punën e bërë nga bashkia Divjakë për plotësimin e të gjithë formateve të SMBV-së sipas udhëzimeve;
- Relacioni i përcjellë në Ministrinë e Financave është përgatitur në përputhje me kërkesat sipas shtojcës 2 të Udhëzimit;
- Programet buxhetore të përdorura nga bashkia janë në përputhje me përcaktimet e shtojcës së udhëzimit të raportimit me 20 programe buxhetore;

4. Analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore

Të Ardhurat: në tabelë paraqitet një përmbledhje e burimeve buxhetore të bashkisë. Nga të dhënat vërejmë se burimet buxhetore të bashkisë Divjakë janë të harmonizuara me tavanet buxhetore përkatësisht me të dhënat e raportit PBA1 "Tavanet Përgatitore të PBA", nëse zbresim transfertën e kushtëzuar (analiza në vazhdim bëhet pa përfshirë vlerën e transfertës së kushtëzuar për periudhën afatmesme).

Burimet Buxhetore		2023 Fakti	2024 Fakti	2025 Plani Fillues	2026 Plani i Rishikuar	2026 Plani	2027 Plani	2028 Plani
1	TE ARDHURA NGA BURIMET E VETA	126,119	138,101	188,690	188,690	180,664	186,864	189,800
1.1	TAKSA E PASURISË SË PALUAJTSHME	45,060	49,638	75,698	75,698	57,598	61,558	65,498
1.2	TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDERTIMET E REJA	11,007	4,961	9,000	9,000	13,500	14,000	14,500
1.3	TAKSA TË TJERA VENDORE	521	578	609	609	2,880	2,960	2,580
1.4	TARIFA VENDORE	65,581	78,259	97,331	97,331	91,186	92,266	92,722
1.5	TE ARDHURA NGA ASJETET DHE AKTIVITETI EKONOMIK	3,950	4,665	6,052	6,052	15,500	16,000	14,500
1.6	TE TJERA ADMINISTRATIVE	0	0	0	0	0	0	0
2	TRANSFERTA NGA BUXHETI QENDROR	710,202	1,320,064	899,295	973,858	794,055	815,088	825,517
2.1	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR E PËRGJITHSHME	305,303	531,939	338,137	338,137	348,677	359,389	369,839
2.2	TRANSFERTA E PAKUSHTËZUAR SEKTORIALE	121,168	307,324	167,078	167,078	167,078	167,078	167,078
2.3	TRANSFERTA TË KUSHTËZUARA	283,731	680,802	394,080	468,643	278,300	288,621	288,600
2.4	TRANSFERTE SPECIFIKE	0	0	0	0	0	0	0
3	TE ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA	30,885	34,084	29,938	29,938	31,200	32,200	33,200
4	GRANTE DHE TRANSFERTA TË TJERA	0	0	0	0	0	0	0
5	HUAMARRJA	0	0	0	0	0	0	0
6	TRASHËGIMI NGA VITI I KALUAR	59,925	102,451	269,057	394,580	61,612	47,985	45,000
TOTALI I TE ARDHURAVE TË NJQV		927,131	1,594,700	1,386,967	1,567,058	1,067,531	1,082,017	1,092,517

Vërehet që sa i përket të ardhurave nga burimet e veta, bashkia Divjakë ka planifikuar të ardhurat nga burimet e veta në vitin 2026 me ulje rreth 4.3% kundrejt atyre të rishikuara në 2025 dhe në vitet 2027 dhe 2028 me rritje 3.4% dhe 1.1% nga viti paraardhës. Në burimet totale

- të bashkisë Divjakë të ardhurat nga burimet e veta zënë një peshë të relativisht të ulët prej rreth 23%. Në total rritja e burimeve buxhetore parashikuar nga viti në vit është: në vitin 2026 burimet buxhetore rezultojnë me ulje 25% nga buxheti rishtikuar i vitit 2025, kjo si rezultat edhe i fondit të lartë të trashëgimit nga viti kaluar, kurse në vitin 2027-2028 ka një rritje prej 0.5% dhe 1.4% nga viti paraardhës. Sipas peshës së tyre transfertat nga buxheti qendror zënë 65-67% të burimeve kurse të ardhurat e veta vetëm 23% të tyre, dhe fondet e trashëguara planifikohen rreth 6-7% çdo vit. Rritja kryesore e burimeve buxhetore parashikuar nga viti në vit, është kryesisht nga rritja e planifikuar nga transfertat e buxhetit qendror

Rekomandohet që bashkia Divjakë të rrisë performancën e mbledhjes së të ardhurave nga burimet e veta duke siguruar një qëndrueshmëri dhe autonomi më të madhe financiare në raport me të ardhurat që i transferohen nga buxheti qendror.

Shpenzimet: Në tabelë paraqiten shpenzimet buxhetore në nivel llogarie ekonomike në vite. Vërehet që sigurisht buxheti i të ardhurave dhe shpenzimeve është i balancuar.

KODI	EMËRTIMI I LLOGARISË	FAKTI 2023	FAKTI 2024	Filëstar 2025	Rishikuar 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028
	Shpenzime Personeli (600-601)	331,507	356,361	447,707	450,505	449,419	449,419	449,419
600	Page, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	284,674	305,500	383,983	386,383	385,293	385,293	385,293
601	Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	46,833	50,861	63,724	64,126	64,126	64,126	64,126
	Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661)	362,766	111,905	221,869	240,896	215,245	215,691	215,691
602	Mallra dhe shërbime të tjera	123,465	111,905	201,167	220,563	194,543	194,989	194,989
604	Transferime korrente të brendshme	6,010	0	20,702	20,333	20,702	20,702	20,702
606	Transferta për buxhetet familjare dhe individët	233,291	0	0	0	0	0	0
609	Rezervat	0	0	0	0	0	0	0
	Shpenzime Kapitale (230-232, 255)	116,010	51,052	323,309	427,010	124,567	128,307	139,807
230	Shp për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupezuara	0	0	0	0	0	0	0
231	Shpenz për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupezuara	116,010	51,052	323,309	427,010	124,567	128,307	139,807
	TOTALI	810,283	519,318	992,885	1,118,415	789,231	793,417	804,917

Referuar tabelës së mësipërme, konstatojmë se shpenzimet në total në vitin 2026 kanë një ulje me rreth 29.4 % krahasuar me vitin 2025, në vitin 2027 dhe 2028 paraqiten me rritje me 0.5% dhe 1.4% krahasuar me vitin paraardhës.

Shpenzimet e personelit (600+601)

Shpenzimet e personelit janë parashikuar në të njëjtat vlera në të tre vitet e PBA-së; në vitin 2026, parashikohet të zënë 56.9% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për këtë vit, në vitin 2027 parashikohet të zënë 56.6% ndaj totalit, dhe në vitin 2028 parashikohet të zënë rreth 55.8% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara për këtë vit.

Shpenzimet korente të tjera (602-606, 609, 651)

Shpenzimet e operative dhe të tjera në vitin 2026-2028, parashikohet të zënë mesatarisht rreth 27-28% ndaj totalit të shpenzimeve të parashikuara. Ndër to shpenzimet operative përbëjnë rreth 25% kurse transfertat korente të brendshme rreth 2.5%. Edhe këto shpenzime janë parashikuar pothuajse të njëjta në vlerë nominale në të tre vitet e PBA-së. Vihet re se bashkia Divjakë referuar tabelës së tavaneve buxhetore ka planifikuar fond rezervë dhe fond kontigjence, por në tabelën e mësipërme të shpenzimeve buxhetore në nivel llogarie ekonomike, këto fonde nuk dalin ku duhet tek rezervat llogaria 609, por janë përfshirë në llogarinë 606. Rekomandojmë të korrigojohet ky zë në fazën e dytë të PBA.

Shpenzimet për Investime (230-231)

Shpenzimet për investime në vitin 2026 parashikohen të zënë 15.8% të totalit të shpenzimeve të bashkisë të parashikuara për këtë vit, në vitin 2027 parashikohet të zënë 16.2% ndaj totalit të shpenzimeve, dhe në vitin 2028 parashikohet të zënë rreth 17.4%.

Nisur nga përqindjet e gjeneruara nga të dhënat që shpenzimet kapitale të brendshme zënë ndaj totalit, rekomandojmë rritjen e këtij raporti në mënyrë që shpenzimet për investime të zënë peshë më të madhe ndaj totalit, si të tilla atyre duhet t'u jenet prioritet duke qenë se

ndikojnë drejtëpërsëdrejti në jetën e komunitetit të përkthyer ndryshe në punë publike. Nisur nga rëndësia që ato kanë duhet përkthyer me një trend rritës ndër vite dhe duhet shoqëruar dhe me rritjen e peshës që ato zënë ndaj totalit.

5. Shpenzimet sipas funksioneve

Shpenzimet sipas funksioneve në vlerë dhe në përqindje për vitin 2024 dhe tre vitet e PBA 2026-2028, sipas të dhënave të gjeneruara po nga Sistemi Menaxhimit të Buxhetit Vendor e më saktësisht raportit PBA4, paraqiten të përmbledhura në tabelën e mëposhtme.

KODI	EMËRTIMI I FUNKSIONIT	RISHIKUAR 2025	PLANI 2026	PLANI 2027	PLANI 2028	Rishikuar 2025 në %	Pesha % 2026	Pesha % 2027	Pesha % 2028
01	SHËRBIMET E PËRGJITHSHME PUBLIKE	411,947	337,976	341,162	347,976	36.8%	42.8%	43.0%	43.2%
03	RENDI DHE SIGURIA PUBLIKE	35,009	31,318	31,765	31,765	3.1%	4.0%	4.0%	3.9%
04	CESHTJET EKONOMIKE	387,177	190,251	193,251	195,937	34.6%	24.1%	24.1%	24.3%
05	MBROJTJA E MJEDISIT	15,599	15,599	15,599	15,599	1.4%	2.0%	2.0%	1.9%
06	STREHIM DHE KOMODITETET E KOMUNITETIT	108,604	107,514	107,514	107,514	9.7%	13.6%	13.6%	13.4%
07	SHENDETESIA	0	0	0	0	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
08	ARGETIM , KULTURA DHE CESHTJET FETARE	20,042	18,042	18,042	18,042	1.8%	2.3%	2.3%	2.2%
09	ARSIMI	136,630	87,531	87,084	87,084	12.2%	11.1%	11.0%	10.8%
10	MBROJTJA SOCIALE	3,408	1,000	1,000	1,000	0.3%	0.1%	0.1%	0.1%
	Totali	1,118,415	789,231	793,417	804,917	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Vërejmë se ndër funksionet më kryesore të cilat përkthehen dhe në peshën më të lartë për periudhën 2026-2028 në programin buxhetor afatmesëm, mund të përmendim funksionin 01 Shërbimet e Përgjithshme Publike që zë rreth 43% të totalit të buxhetit, funksionin 04 Çështjet Ekonomike që zë rreth 24% me programin 04520 Rrjeti rrugor rural që zë pjesën më të madhë me 15%. Më pas vjen funksioni 06 Strehimi dhe Komoditetet e Komunitetit me peshë rreth 13.5% dhe funksioni 09 ARSIMI që zë 11% ku programi 09120 Arsimit bazë përfshirë sistemin e arsimit parashkollor zë pjesën më të madhe të tij. Funksionet e tjera të Mbrojtjes së Mjedisit, Sigurisë Publike dhe Mbrojtjes Sociale zënë një përqindje më të vogël buxhetore për periudhën afatmesme 2026-2028.

6. Projektet prioritare të investimeve në periudhën afatmesme

Referuar të dhënave të gjeneruara nga raporti PBA 8 “Projektet e Investimeve” për bashkinë Divjakë janë renditur shpenzimet kapitale për projektet e investimit të nënmarra nga bashkia me financim të brendshëm, nga të cilat një pjesë e madhe sipas parashikimeve përfundojnë brenda vitit 2025 ndërsa një pjesë tjetër të shtrihet përgjatë periudhës afatmesme 2026-2028. Vërejmë se për të njëjtin emërtim projekti bashkia ka propozuar kode të ndryshëm në secilin vit të PBA si psh “Blerje kosha metalik Xingato” ndërkohë që parashikohen investime pa emërtime konkrete por me emërtimin psh “Investime për vitin 2026”, “Investime për vitin 2027”, “Investime për vitin 2028”. Rekomandojmë evidentimin e shpenzimeve kapitale sipas çdo projekti konkret me emërtimet e tyre.

7. Detyrimet e prapambetura

Sipas raportimit për detyrimet e prapambetura në SMBV, bashkia Divjakë ka identifikuar stokun e detyrimeve të prapambetura, për vitin 2025 në vlerën rreth 23,5 milion lekë për të cilën ka planifikuar shlyerjen e tij përgjatë vitit 2025 dhe një pjesë në 2026.

Rekomandohet të hartohet një plan realist shlyerjeje për detyrimet e prapambetura dhe të ndiqet me seriozitet dhe përpikmëri plani i shlyerjes sipas parashikimit për detyrimet e prapambetura për periudhën afatmesme. Gjithashtu të parandalohet krijimi i detyrimeve të reja për vitet e parashikuara në dokumentin e hartuar.

8. Raporti i objektivave të synuar dhe produktet

Bashkia Divjakë përkatësisht bazuar në outputet e raporteve të gjeneruara nga SMBV-ja në raportet PBA6 "Deklarata e Politikës së Programit" dhe PBA7 "Shpenzimet e produkteve të programit" ka paraqitur dhe plotësuar të dhënat përkatësisht në Deklaratën e Politikës së Programit duke raportuar qëllimet dhe objektivat dhe të dhënat për treguesit e performancës të lidhur me to për vitin bazë, periudhën afatmesme 2026-2028 dhe synimin për periudhën përtej. Gjithashtu ka paraqitur në raportin PBA7 Shpenzimet e produkteve të programit" lidhjen e objektivave me produktet, të cilat jo gjithmonë janë paraqitur në përputhje me listën orientuese të produkteve standarde të shtojcës 4 të Udhëzimit "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendore 2026-2028". Psh ka produkte si "kontrata në proces", "të tjera" apo "Të ardhura jashtë limiti të trashëguara" që nuk klasifikohen në fakt si produkte. Po ashtu në përgjithësi njësia matëse e produktit është vënë %.

Vlerësojmë punën e bërë nga bashkia Divjakë për plotësimin dhe paraqitjen e të dhënave sipas kërkesave por rekomandojmë paraqitjen e shpenzimeve të produktit në përputhje me listën orientuese të produkteve standarde të shtojcës 4 të Udhëzimit. Ky informacion i detajuar do t'i shërbejë bashkisë për evidentimin e performancës së shërbimeve/ produkteve të ofruara në veçanti për komunitetin. Përmirësimi i këtyre treguesve do të jetë një tregues pozitiv jo vetëm për përmirësimin e shërbimeve të ofruara, por do të kontribuojë dhe arrijtjen e objektivave strategjikë duke qënë se ky informacion shërben për matjen e performancës së programeve në tërësi.

9. Rekomandime

- Roli kryesor i PBA-së është të sigurojë që politikat, objektivat dhe qëllimet të jenë të përcaktuara qartë si dhe produktet e synuara do të arrijnë objektivat dhe qëllimet e politikës në një mënyrë që krijon një përdorim ekonomik, eficient dhe efektiv të fondeve buxhetore. Bashkia Divjakë ka përcaktuar qëllimet e politikës së programit, objektivat dhe treguesit e performancës në nivel objektiv, por ka nevojë në përmirësimin e përcaktimit të saktë të produkteve me njësitë matëse dhe sasi të përkatëse.
- Rekomandojmë paraqitjen e produkteve në përputhje me listën orientuese të produkteve standarde të shtojcës 4 të Udhëzimit. Po ashtu rekomandojmë evidentimin e shpenzimeve kapitale me projekte konkrete me emërtimet e tyre përkatëse.
- Rekomandojmë të rritet performanca e mbledhjes së të ardhurave nga burimet e veta në raport me të ardhurat nga buxheti qendror, me qëllimin që kjo njësi e vetëqeverisjes vendore të ketë një qëndrueshmëri dhe autonomi më të madhe financiare.
- Të rritet pesha që shpenzimet për investime zënë në buxhetin e bashkisë duke synuar njëkohësisht që shpenzimet e personelit dhe ato korente të jenë të qëndrueshme dhe në rënie të vazhdueshme në funksion të rritjes së shpenzimeve për investime.
- Të ndiqet me seriozitet dhe përpikmëri plani për shlyerjen e detyrimeve aktuale që ka bashkia Divjakë deri në zerimin e tyre dhe të parandalohet krijimi i detyrimeve të reja për vitet ardhshme.
- Rekomandojmë që në fazën e dytë të PBA-së, të reflektohen komentet e Ministrisë së Financave me qëllim përmirësimin e dokumentit në dobi të rritjes së efikasitetit të ofrimit të shërbimeve publike.